

Vendim nr. 5 datë 14.01.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 14.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 46 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ANDRI LEKA**, përfaqësuar nga avokat Eno Seferi, me prokurë të posaçme

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve datë 20.01.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1608, datë 19.10.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2024-580, datë 04.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33, 34, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 132 dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 2 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhoma penale) është paraqitur për gjykim çështja penale në ngarkim të kërkuesit, i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie”, kryer në bashkëpunim dhe “Përndjekja”, parashikuar nga nenet 109/b, paragrafi i parë dhe 121/a, paragrafi i parë, të Kodit Penal (KP). Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje rezulton se në seancën e datës 20.01.2023 mbrojtësi i kërkuesit nuk është paraqitur. Për këtë arsye, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, po në të njëjtën seancë, i ka caktuar atij një mbrojtës kryesisht dhe ka disponuar për pezullimin e afateve të paraburgimit deri në seancën e ardhshme. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

2. Pas përfundimit të gjykimit të çështjes, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1569, datë 16.06.2023, ka vendosur të deklarojë fajtor kërkuesin për veprën penale “Përndjekja”, të parashikuar nga neni 121/a, paragrafi 1, i KP-së, duke e dënuar atë me 3 vjet e 3 muaj burgim, ndërsa vuajtja e dënimit fillonte nga dita e ndalimit, data 22.07.2021. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim, mbi bazën e të cilit çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Ndërsa çështja ka qenë në pritje për t’u gjykuar, mbi kërkesën e kërkuesit, ajo gjykatë, me vendimin nr. 1646 (30-2023-5102), datë 23.09.2023, ka vendosur deklarinimin të shuar të masës së sigurimit “Arresti në burg” caktuar ndaj tij me vendimin nr. 1262 akti, datë 25.07.2021 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për shkak se kohëzgjatja e paraburgimit e vuajtur nga ai nën këtë masë ishte më e madhe se sa masa e dënimit me burgim të caktuar për të me vendimin nr. 1569, datë 16.06.2023 të asaj gjykate. Në këtë rast, gjykata e apelit ka urdhëruar edhe lirimin e menjëhershëm nga paraburgimi të kërkuesit nëse nuk mbahej për ndonjë masë tjetër sigurimi personal “Arresti në burg” ose vendim penal dënimi.

3. Ndërkohë, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendim nr. 1608, datë 19.10.2023, ka vendosur mospranimin e ankimit të kërkuesit për kundërshtimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë të datës 20.01.2023 për pezullimin e afateve të paraburgimit, duke arsyetuar se ai (ankimi) nuk ka më objekt, pasi sipas vendimit nr. 1646, datë 23.09.2023 të së njëjtës gjykatë, rezulton se kërkuesi nuk është më në gjendje paraburgimi, ndaj duhet të vendoset mospranimi. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-580, datë 04.04.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në pikën 1 të nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. Në datën 11.10.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27, pika 5, të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 04.11.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, duke argumentuar:

6.1. Gjykata e apelit duhet të konstatonte faktin se gjykata e shkallës së parë nuk e kishte zbardhur vendimin e saj për pezullimin e afateve të paraburgimit, pasi referuar legjislacionit procedural, ajo është e detyruar që vendimmarrjen e saj ta arsyetojë me shkrim. Moszbardhja dhe mosarsyetimi i vendimit konsiderohen shkelje të procesit të rregullt.

6.2. Nga interpretimi i nenit 265 të KPP-së, gjykata i ka të përcaktuara rastet se kur mund të pezullojë afatet e paraburgimit, të cilat janë vetëm përpara përmbushjes së dy kushteve kryesore, që në rastin konkret i referohet shkronjës “b” të kësaj dispozite. Ky pezullim ndodh vetëm në rastet kur mbrojtësi nuk është paraqitur dhe ka lënë pa ndihmë një apo më shumë të pandehur. Gjykata e shkallës së parë ka caktuar mbrojtës kryesisht pa vullnetin e kërkuesit, në shkelje të neneve 6 dhe 34 të KPP-së. Këto shkelje nuk janë marrë parasysh nga gjykata e apelit.

6.3. Gjykata e apelit e ka gjykuar ankimin e kërkuesit pas 10 muajve nga paraqitja e tij, duke tejzgjatur kështu gjykimin e çështjes dhe duke mos e gjykuar atë brenda një afati të arsyeshëm.

6.4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është mbështetur në të njëjtin arsyetim të gjykatës së apelit, duke mos kuptuar rekursin e paraqitur nga kërkuesi, i cili lidhej jo me afatet e paraburgimit, por me paligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë në gjykimin e çështjes.

6.5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit, pasi nuk ka bërë një vlerësim nëse gjykatat më të ulëta, për shkak të interpretimit të ligjit procedural, i kanë cenuar ose jo kërkuesit të drejtën për proces të rregullt, si edhe

nëse ato kanë rënduar pozicionin e tij, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs.

6.6. Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjykatat kanë detyrimin të shqyrtojnë efektet që krijohen me kufizimin e lirisë për shkak të pezullimit të kohës së paraburgimit, pavarësisht faktit nëse kërkuesi në kohën e shqyrtimit të çështjes ndodhet në kushtet e kufizimit të saj. Në këtë mënyrë, gjykatat kanë cenuar lirinë personale të kërkuesit dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Kolegji vëren se një nga kriteret për të ushtruar ankim kushtetues individual është edhe *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës. Në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata ka pohuar se mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të zbatohet në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtjshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rastin konkret, Kolegji vëren se ky gjykim kushtetues është vënë në lëvizje për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të vendimeve gjyqësore që kanë vendosur pezullimin e afateve të paraburgimit të kërkuesit, të cilat kanë natyrë të ndërmjetme dhe jo përfundimtare, pasi janë dhënë në kuadër të një procedimi penal që është zhvilluar në ngarkim të kërkuesit, në përfundim të të cilit ai është shpallur fajtor.

10. Po ashtu, Kolegji konstaton se në jurisprudencën e saj Gjykata ka bërë objekt të kontrollit kushtetues vendimet gjyqësore të ndërmjetme që kanë caktuar ose zëvendësuar masat e sigurimit personal të arrestit, për sa kohë ka vlerësuar se ato kanë natyrë përfundimtare, për shkak se kanë ndërhyrë në lirinë personale të individit. Ndërkohë, në rastin konkret, referuar kërkesës dhe pretendimeve të kërkuesit, Kolegji vëren se ato nuk kanë të bëjnë me vendimet gjyqësore për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, por me mënyrën e ekzekutimit të saj, të cilën ai e ka vuajtur tashmë. Për rrjedhojë, në vlerësimin e Kolegjit, vendimet e kundërshtuara jo vetëm që janë me natyrë të ndërmjetme, për shkak se janë dhënë në kuadër të një procedimi penal që është zhvilluar ndaj kërkuesit, por ato as nuk kanë kufizuar të drejtat substanciale të tij, kufizim i cili ishte vendosur me vendimet që kanë disponuar për masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, të caktuar ndaj tij. Për këtë arsye, Kolegji çmon se vendimet e kundërshtuara nga kërkuesi në këtë ankim kushtetues individual nuk mund të quhen përfundimtare për efektet e gjykimit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ndaj ai nuk legjitimohet për kundërshtimit e tyre, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike efektive.

11. Për sa më lart, në kushtet kur një nga kriteret paraprake për legjitimim, konkretisht ai i shterimit të *mjeteve juridike efektive* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

12. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi nuk i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.